



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

KËSHILLI KONSULTATIV
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr 284 prot

Tiranë, më 26.5.2026

VENDIM

Nr. 7 datë 26.5.2026

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE
VENDORE TË DATËS 14/5/2026

Këshilli Konsultativ bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, si dhe në VKM nr. 244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme të mbledhjes së datës 14. 5. 2026 vendosi:

1. Për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 459, datë 30.7.2021, të Këshillit të Ministrave ”Për përcaktimin e rajoneve të zhvillimit dhe kufijve të tyre”, propozuar nga Zëvendëskryeministri, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektvendimin.
2. Për projektvendimin ”Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 479, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin (KKZHRK)”, propozuar nga Zëvendëskryeministri, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, shprehën

dakordësinë në parim me projektvendimin.

3. **Për projektligjin “Për masat për zvogëlimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta-akti i infrastrukturës Gigabit”**, propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektligjin.
4. **Për projekturdhërin e Kryeministrit “Për ngritjen e task-forcës ndërinstitucionale për sezonin turistik 2026”**, propozuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projekturdhërin.
5. **Për projektvendimin “Për miratimin e kritereve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve”**, propozuar nga Ministria e Mjedisit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
 - Të përfshihet një nen që përcakton se tarifat për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve miratohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për pushtetin vendor dhe financat vendore, pra të rregullohet struktura tarifore e menaxhimit të integruar të mbetjeve;
 - Të përfshihet një dispozitë e qartë mbi rolin operacional të njësive të vetëqeverisjes vendore në zbatimin e grumbullimit të diferencuar, duke përcaktuar detyrimin për hartimin e planeve lokale të ndarjes në burim, organizimin e shërbimit dhe pilotimin gradual të skemave sipas zonave urbane dhe rurale;
 - Të parashikohet se faza e parë e zbatimit të grumbullimit të diferencuar të fokusohet në ndarjen e mbetjeve organike nga ato riciklueshme, si një hap bazë dhe i zbatueshëm në shkallë kombëtare;
6. **Për projektvendimin “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme për ushtrimin e kompetencave të inspektoriatit të përgjithshëm, rregullat për përmbajtjen, administrimin e te dhënave të sistemit elektronik ”e-inspektimi”, mënyrën e raportimit, kërkimit të informacionit, inspektimit të dosjeve dhe dokumentave të nevojshme, si dhe mbikëqyrjen në terren të procedurave të inspektimit”**, propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektvendimin.
7. **Për projektudhëzimin “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave dhe vlerat mesatare të shitblerjes së banesave në treg, për vitin 2025, në përputhje me shkronjën”dh”, të nenit 72 të ligjit nr. 22/2018,”Për strehimin social”, i ndryshuar**, propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektudhëzimin.

8. **Për projektvendimin “Për përcaktimin e kritereve, procedurës, mënyrës së transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin dhe të formatit tip të kontratës”,** propozuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektvendimin.
9. **Për projektvendimin “Për miratimin e rregullores tip “Për administrimin e banesave dhe ndërtesave””,** propozuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Të reflektohen komentet e bashkisë Tiranë për nenet 4, 5 pasi referuar shkronjës ‘b’ të pikës 10 të nenit 3 të ligjit 55/2025 përkufizimi i termit “Ndërtesë” e parashikon dhe kompleksin si përkufizim të saj. Referuar dy komenteve të para në nenin 6 të rregullores, roli i bashkisë dhe afati 30 ditor i saj është parashikuar në pikën 2 dhe rregullorja është e strukturuar në përputhje me parashikimet e nenit 1 të ligjit 55/2025, në lidhje me pikën 4, theksoj se formatet apo dhe konkretizimi i procedurave me akte nuk është në kompetencën tonë për aq kohë sa kjo rregullore është e formës “TIP”, që do të thotë se do të shërbej si një referim i cili më vonë mund të përshtatet sipas karakteristikave të banesave për secilën bashki;
 - Të reflektohet komeneti referuar nenit 7, në lidhje me përcaktimin e rendit të ditës, pika 1 e nenit 18 të ligjit parashikon shprehimisht ‘afishimin’ për mbledhjen e radhës dhe jo ‘përcaktim’ për mënyrën e mbajtjes së saj në tërësi duke përfshirë dhe rendin e ditës;
 - Të reflektohet komenti në lidhje me pikën ‘g’ e nenit 9 në lidhje me procedurat e hapjes së llogarisë bankare, ligji parashikon se administratori regjistrohet në administratën tatimore dhe pajiset me NUIS, gjë e cila nënkupton se automatikisht administrator apo shoqëria e administrimit ka status juridik;
 - Të reflektohet komenti referuar nenit 10, duke sqaruar se rregullorja TIP synon të parashikoj rregulla të përgjithshme dhe formatet për procedurat e detajuara do të mbeten në diskrecion të individëve përgjegjës;
 - Të reflektohet komenti referuar nenit 14, procedura e kontraktimit të administratorit rregullohet nga një akt tjetër nënligjor i detajuar;
 - Të reflektohet komenti referuar nenit 15;
 - Të reflektohet komenti referuar nenit 17, ku sqarohet se “Standardi i Administrimit” duhet të kuptohet si niveli minimal i detyrueshëm i shërbimeve dhe i mirëmbajtjes së hapësirave të përbashkëta me qëllim garantimin e funksionimit normal të ndërtesës në bahskëpronësi. Në këto kushte detajet lihen për përcaktim në juridiksionin e secilit sipas nevojave/kushteve përkatëse;
 - Të reflektohet komenti referuar nenit 20, termi ‘kontribute të rregullta’ i cili ka kuptimin e detyrimeve sipas parashikimeve të ligjit 55/2025 dhe komenti për zëvendësimin e termit ‘gjobë’ me ‘kamat’ pasi të dyja këto janë të ndryshme në qëllim nga njëra tjetra. Gjopa në këtë rast ka karakter ndëshkues në rast të shkeljes së parashikimeve ligjore dhe të rregullores dhe jo karakter kompensues në rast të mos plotësimit të një detyrimi në kohën e kërkuar;
 - Të reflektohet komenti referuar nenit 29, nëpërmjetë së cilës kërkohet një procedurë më e detajuar mbi dëmet e shkaktuara të vendosjes së depozitave të ujit, ku kjo rregullore tip përcakton parimet dhe rregullat e përgjithshme për administrimin e bashkëpronësisë, pa synuar rregullimin shterues të procedurave administrative dhe operationale në rast

shkeljesh. Përcaktimi i procedurave konkrete për konstatimin e shkeljeve, vendosjen e masave dhe heqjen e ndërhyrjeve të paligjshme rregullohet nga legjislacioni në fuqi;

- Të reflektohet komenti referuar nenit 33, çështjet që lidhen me funksionimin e asamblesë, organizimin e kryesisë, si dhe mënyrën e mbajtjes së kartelës dhe aktit të bashkëpronësisë që rregullohen nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore;
- Të reflektohet komenti referuar nenit 35, ku kjo rregullore nuk parashikon detyrime të drejtpërdrejta për lidhjen e kontratave të mirëmbajtjes apo për procedura inspektimi, pasi ka karakter rregullator dhe jo detyrues operacional;
- Të reflektohet komenti referuar nenit 36, detajimi i elementëve të mirëmbajtjes së zakonshme dhe të jashtëzakonshme parashikohet në ligjin 55/2025 dhe në dispozitat paraardhëse të kësaj rregullorej;
- Të reflektohet komenti referuar nenit 41, ku ky paragraf është parashikim ligjor, neni 10 i ligjit 55/2025;
- Të reflektohet komenti referuar nenit 43, strukturimi i dispozitave i cili është bërë në mënyrë të atillë me qëllim grupimin e tyre sipas zërave përkatës, si dhe është ndjekur ky strukturim duke i renditur ato njëra pas tjetrës në mënyrë që te kuptohen të pandara;
- Të reflektohet komenti referuar nenit 51, sipas të cilit është menduar një parashikim sa më gjithëpërfshirës.

Z. Ervin Demo
Ministër Shteti për Pushtetin Vendor

Z. Aldrin Dalipi
Kryetar/Bashkëkryetar

Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë